

URDHËR
Nr. 97, datë 16.3.2022

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 372, DATË 11.6.2021,
TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR
PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-
19, NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE INSTITUCIONET E
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, neni 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, neni 9, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, neni 5, pika 6, të ligjit nr. 80/2020, “Për policinë e Burgjeve”, pikës 5, të urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, përcjellë me shkresën nr. 2802 prot., datë 7.3.2022,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 1, germa “f/i” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“i. Të burgosurit meshkuj kanë të drejtën e vizitës 1 (një) herë në muaj, ndërsa të burgosurat femra kanë të drejtën e vizitës 4 (katër) herë në muaj, duke garantuar higjienën e nevojshme, kontrollin shëndetësor gjatë hyrjes, kontrollin e pasjes nga ana e vizitorit të vërtetimit nga autoritetet shëndetësore përkatëse ose analizës/dëshmisë sereologjike mbi shërimin rishtazi nga COVID-19, testit të vlefshëm negativ nga infektimi me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 ose vërtetimit/dëshmisë së vaksinimit të plotë anti-COVID-19.”

2. Pas germës “f/ii”, të pikës 1, shtohet germa “f/iii” me këtë përmbajtje:

“iii. Të burgosurit meshkuj dhe femra, të martuar apo që bashkëjetojnë sipas Kodit të Familjes, kanë të drejtën e takimit të zgjatur 1 (një) herë në muaj, duke garantuar higjienën e nevojshme, kontrollin shëndetësor gjatë hyrjes, kontrollin e pasjes nga ana e vizitorit të vërtetimit nga autoritetet shëndetësore përkatëse ose analizës/dëshmisë sereologjike mbi shërimin rishtazi nga COVID-19, testit të vlefshëm negativ nga infektimi me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 ose vërtetimit/dëshmisë së vaksinimit të plotë anti-COVID-19.”

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, Sektori i Shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja